



# **AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE**

## **Dobësi Kritike në BeyondTrust Remote Support (RS) dhe Privileged Remote Access (PRA)**

Data: 10/02/2026

Version: 1.0

## Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive .....	1
Informacione Teknike .....	1
Rekomandime .....	2
Referenca .....	2

### Përmbledhje Ekzekutive

---

Është identifikuar një dobësi kritike e ekzekutimit të kodit nga distanca (RCE) në BeyondTrust Remote Support (RS) dhe Privileged Remote Access (PRA). Dobësia është e shfrytëzueshme përpara autentikimit dhe mund t'i lejojë një sulmuesi të paautentikuar nga distanca të ekzekutojë komanda të sistemit operativ. Shfrytëzimi me sukses mund të rezultojë në komprometim të plotë të sistemit, ekfiltrim të të dhënave dhe ndërprerje shërbimi.

### Informacione Teknike

---

#### Detaje të Dobësisë:

- **CVE ID:** CVE-2026-1731
- **CWE:** CWE-78 – Neutralizim i pasaktë i elementëve specialë të përdorur në komandat e sistemit operativ
- **CVSS v4 Score:** 9.9 (Kritike)
- BeyondTrust Remote Support dhe disa versione më të vjetra të Privileged Remote Access përmbajnë një dobësi RCE **para autentikimit**.
- Duke dërguar **kërkesa të formuara posaçërisht**, një sulmues i paautentikuar mund të ekzekutojë **komanda arbitrare të sistemit operativ** në kontekstin e përdoruesit të aplikacionit.
- Dobësia **nuk kërkon autentikim dhe nuk kërkon ndërveprim nga përdoruesi**, duke përbërë një **rrezik shumë të lartë** për sistemet e prekura.

#### Produktet e Prekura

- **BeyondTrust Remote Support (RS):** Versionet **25.3.1** dhe më herët
- **BeyondTrust Privileged Remote Access (PRA):** Versionet **24.3.4** dhe më herët

#### Versionet e Rregulluara / Mitigime

##### Remote Support (RS):

- Patch **BT26-02-RS**
- Versioni **25.3.2** dhe më i ri

##### Privileged Remote Access (PRA):

- Patch **BT26-02-PRA**
- Versioni **25.1.1** dhe më i ri

**Shënim:** Versionet e Remote Support më të hershme se **21.3** ose versionet e Privileged Remote Access më të hershme se **22.1** duhet fillimisht të **përditësohen në një version të mbështetur**, përpara aplikimit të patch-it.

## **Rekomandime**

---

AKSK rekomandon **përditësimin e menjëhershëm të versioneve të prekura në versionet e rregulluara ose më të fundit të publikuara nga BeyondTrust.**

## **Referenca**

---

<https://www.beyondtrust.com/trust-center/security-advisories/bt26-02>